



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenet 4 parag. 1.2 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenin 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës njoftuese nr.30/20 të datës 20 shkurt 2020 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë (për nominim të anëtarit të ri në KKSBB), Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 02 mars 2020, mori,

VENDIM PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKSBB

Neni 1

1. Me këtë vendim bëhet zëvendësimi i një anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe atë:

z. Osman Kurtolli, ish Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë,
zëvendësohet nga,

z. Mensur Hoti, Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë

2. Zëvendësimi i anëtarit të cekur, bëhet sipas detyrës zyrtare, konform Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nr.01-020/04-0038894/18 i datës 11 maj 2018.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-020/04-0016335/20
Podujevë,
02 mars 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi